



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Pranimë Me Datë ... 07.08.2026			
Nr. Llogarit Org. Broj	Numri Broj	Shtetësi Pjesë	Vlera Vendnost
07	060/07	795	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **VII** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **14.08.2026 (e Premte)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit në objektin e vjetër të komunës së Vitisë. Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 2026 (Janar-Qershor 2026)

Viti, më 07.08.2026

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E GJASHTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.07.2026 (e mërkurë)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Elsa Jahija, zn.Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përsëritet për nënkryetarin e Komunës, për të gjithë ju anëtarë të KPF-së dhe drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të KPF-së. Materialin e keni marrë me kohë. Para se me hy në rend të ditës, sa i përket akteve të ligjshmërisë, gjatë kësaj periudhe nuk na është raportu që kemi diçka jo në rregull lidhur me vendimet. Po ashtu, para fillimit të takimit, e dimë që para dy ditësh kemi pasë një gjendje të rëndë në komunën e Vitisë, si pasojë e stuhive që kanë qenë. Gjithashtu, shprehi ngushëllimet e mia familjes Pira për humbjen e familjarit nga stuhia, ndërsa dy të lënduarve u dëshirojmë shërim të shpejtë. Ndërsa, të gjithë atyre që kanë pësuar dëme materiale gjatë kësaj fatkeqësie natyrore urojmë që të bëhet një kompensim dhe t'u ndihmohet, sepse me të vërtetë është e rëndë kur, si pasojë e një fatkeqësie, njerëzit e humbin një pjesë të madhe ose një pjesë të pasurisë së tyre, pësojnë dëmtime të ndryshme apo humbin punën që e kanë bërë gjatë verës. Megjithatë, fatkeqësitë janë të tilla dhe njerëzit janë të pafuqishëm në raste të tilla me vepru. Para se të hyjmë në rend të ditës, e hapi debatin.

z.Illir Zuka: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Kam pasë shumë gjëra me diskutu, por ditëve të fundit që i kemi kalu në Pozheran, ato gjëra të gjitha bien poshtë, tue e ditë që kemi qenë edhe epiqendra e krejt kësaj. Pozherani, Sllatina, Remniku e Klllokoti janë prekë, por epiqendra ka qenë te ne, në Pozheran. Shoh një mungesë të institucioneve, tue e ditë gjendjen si kemi qenë para dy ditësh. Kryesues, ti kishe qëllu në Sllatinë, ndërsa ne në Pozheran. Rruga Pozheran-Sllatinë ka qenë e bllokuar për shkak të shembjes së kulmit të plemes dhe ka qenë rrezik. Kam dalë vetë me ndihmu. Banorët janë detyru me e hjek vetë kulmin, domethënë zjarrfikësit kanë ardhë, e kanë kqyrë dhe aq. Rreziku më i madh ka qenë në rrugën "Sabit Zuka", prej vetëtimës që është gjujtë. Pesë shtylla elektrike janë rrëzu përnjëherë dhe kanë qenë në tokë, me tension të lartë, për orë të tëra. Kam thirrë policinë, zjarrfikësit, drejtorin e Shërbimeve Publike dhe KEDS-in. Rryma ardhke e ndalke, ndërsa njerëzit kalojshin aty, çka ka qenë një rrezik shumë i madh. Dikur, rreth orës 21:00, ka ardhë komandanti i zjarrfikësve, kanë vendosë shirita dhe e kanë blloku rrugën. Edhe dje kemi kalu një ditë jashtëzakonisht të rëndë. Edhe unë bashkangjitem me ty, kryesues, dhe ju shprehi ngushëllime familjes. Është e rëndë kur një orë para rri me atë person, e pas një ore merr informacion prej familjarëve të ngushtë që ka vdekë. Ndërsa ata djemtë tjerë, që i

kanë nxanë dyert, për fat kanë shpëtu. Lagjja Zuka ka qenë më e goditura dhe nuk ka shtëpi që nuk i ka lujtë kulmi. Megjithatë, banorët nuk kanë kërku kompensim; kanë thanë që është fatkeqësi natyrore. Unë e di që edhe sot është paralajmëru stuhi dhe ju kisha lutë Komunës, zjarrfikësve dhe të gjitha shërbimeve përgjegjëse që pikat që janë ma të evidentume me rrezik me i shiku ma shumë dhe me qenë ma vigjilentë aty ku ekziston rreziku. Mua askush nuk më ka kontakti si administrator me më pyet se çka ka ndodhë. Unë kam dalë si qytetar i fshatit Pozheran me i ndihmu njani-tjetrit. Kam thirrë shumë njerëz, sepse lagjja Zuka ka qenë e rrezikuar, vetëm që mos të na ndodhin fatkeqësi. Nëse ndodhin, atëherë nuk na mbetet vetëm me dalë në Facebook e me thanë "çka ndodhi". Domethënë, pesë shtylla të tensionit të lartë kanë qenë të rrëzuara në tokë. Kam kontakti edhe televizionin, i cili e ka bërë një lajm, vetëm që institucionet me reagu. Uroj që edhe sot ta kalojmë mirë, por çka do që ndodh, duhet të jemi më vigjilentë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë dje kam qenë në Sllatinë. Dy rrugë kanë qenë të bllokuara, sepse është rrëzu një shtyllë elektrike, ndërsa policia ka dalë brenda orës. Pjesa tjetër ka qenë e bllokuar me tela të rrymës që janë këputë.

z.Jakup Demiri: Në këto raste duhet që Komuna me bërë thirrje që banorët me qëndru brenda shtëpive, sepse kjo është më e sigurt për jetën e qytetarëve. Dëmet që bëhen ne nuk e dimë se sa mundemi me i ndihmu, por problemi kryesor është jeta e njerëzve. Për atë arsye duhet me bërë thirrje që të qëndrohet në vende më të sigurt. Ndërsa, sa i përket kulmit që ish hjekë, ai nuk kish qenë i kapët hiq, veç i lëshuar për me mbajt borën dhe shiun. Për këtë punët këtu nuk janë edhe në rregull që ndodhin këto gjëra, por gjithsesi, në fatkeqësi natyrore mund të ndodhin raste të tilla.

z.Illir Zuka: Prej orës 17:05, kur ka ndodhë rasti, e deri në orën 21:10 janë vendosë shiritat, ndërsa pesë shtylla të tensionit të lartë kanë qenë të rrëzuara në mes të rrugës. Aty ka qenë një rrezik i madh dhe ka mundë me marrë jetë njerëzish.

zn.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ngushëllimeve ju bashkangjitem edhe unë për rastin që ka ndodhë në Pozheran. Ndoshta tani është shumë herët për me pasë një pasqyrim të plotë të situatës, por mendoj që do të ishte mirë që, te pjesa e seancës, të kemi një informim lidhur me vizitat që janë bërë në terren. E kam pa që ka pasë postime nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nga kryetari i Komunës. Është mirë që edhe ne me pasë informacione se si qëndrojmë si komunë, çfarë është gjendja aktuale dhe a ka nevojë për ndërhyrje nga institucionet e nivelit nacional. Natyrisht, ne jemi të hapur për bashkëpunim. Besoj që kjo nuk ka me qenë e nevojshme, por megjithatë do të ishte mirë me pasë një pasqyrë të qartë. Po ashtu, edhe prej Drejtorisë së Bujqësisë do të ishte mirë me marrë një pasqyrim të gjendjes, për shkak se e dimë që si komunë dominohemi nga kulturat bujqësore dhe e kemi pa edhe gjendjen në terren se si ka qenë. Mendoj që në seancë do të ishte mirë me pasë këtë informatë më të detajizuar, se si qëndrojmë si komunë dhe si ka përfunduar vlerësimi i gjendjes.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë ju bashkangjitem ngushëllimeve për rastin që ka ndodhë në Pozheran dhe u dëshiroj shërim të shpejtë atyre dy të lënduarve. Komuna e Vitisë, për dy ditë, u ballafaqu me furtunën dhe ka qenë një gjendje e rënduar, diku më shumë e diku më pak. Ditën e parë, si epiqendër kanë qenë Sllatina dhe Pozherani, ndërsa ditën e dytë Remniku dhe Skifterajt. Dëmet janë të pariparueshme, sidomos për ata të cilët e kanë burim jetese kulturat bujqësore. Unë, personalisht, si nënkryetar i Komunës, kam pasë dëme, por megjithatë kam kontakti me qytetarët dhe kam marrë informacione që u janë dëmtu edhe sipërfaqet me kultura bujqësore. Ne dje kemi mbajtur një takim, për shkak të paralajmërimit që e patëm. Kryetari e ka thirrë bordin e drejtorive dhe e ka ngritë shkallën e gatishmërisë me ato kapacitete që i kemi, qoftë nga aspekti i zjarrfikësve, policisë apo shëndetësisë. Pajtohem me Jakupin që Kosova nuk është e përgatitur, sidomos në aspektin e infrastrukturës, për kesi lloj furtunash, derisa shtetet tjera përgatiten për këto çështje. Edhe unë, me këtë moshën time, për herë të parë kam përjetu një stuhi të tillë. Sot

kanë ardhë kërkesat e qytetarëve dhe u dakordua që ato me iu lajmëru kryetarit të komisionit. Komisionin e kemi të përbashkët për ekonomi dhe bujqësi, ndërsa Mustafa Islami është i caktuar si kryetar i komisionit. Në atë mbledhje e thirrëm edhe Zyrën e Informimit që me i orientu qytetarët se kjo është adresa ku duhet me i paraqitë dëmet. Tash, si do të zhvillohet procedura më tutje, nuk e dimë, por me rëndësi është që ne, si komunë, t'i evidentojmë dhe t'i paraqesim në Kuvend. Unë i shtrova dy çështje me radhë: evidentimin e dëmeve në aspektin ekonomik, ndërsa dëmet në bujqësi kanë një afatshmëri dhe shpesh është e pamundur që Komuna me bë diçka në këtë drejtim. Ilir, ti i shtrove disa çështje. Unë shumë herë kam provu me kontaktu Islamin, por gjithmonë ka qenë i zënë, për shkak se edhe ai ka qenë në detyrë, tue i nxjerrë ekipet në terren. Para dy netësh kam kontaktu rreth orës tetë të mbrëmjes, pastaj prapë rreth orës dhjetë të mbrëmjes kam provu disa herë me kontaktu, por ka qenë i zënë. Ndoshta edhe kapaciteti i burimeve njerëzore në KEDS, për këto lloj furtunash, është i vogël. Unë e di se komandanti i zjarrfikësve ka thënë që gjendja e mjeteve është në rregull. Dje kam vizitu sipërfaqen e Remnikut dhe të Skifterajve, pas rënies së intensitetit të stuhisë, dhe në rrugët kryesore nuk kam vërejt shtylla elektrike të rrëzuara. Mirëpo, në ato vende ku nuk kam hy, nuk e di, sepse edhe sot nuk kemi rrymë në Remnik dhe në disa vende tjera. Liridona, e shtrove një çështje të drejtë, por nuk e di nëse komisioni ka me mujtë që për këtë mbledhje të Kuvendit me e përfundu evidentimin, për shkak se duhet me i pranu kërkesat. Dëmet janë evidente, por mund të kemi edhe kërkesa të paarsyeshme, për dëme të vogla, në krahasim me dëmet e mëdha që duhet të evidentohen. Megjithatë, ne si organe komunale duhet ta kryejmë punën tonë, me i evidentu të gjitha dëmet, me i paraqitë në Kuvend dhe me i dërgu në kanalet përkatëse, deri në ministri. Pastaj, çka bëhet për krejt Kosovën, duhet me u bë edhe për Komunën e Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Uroj që të mos përsëriten më raste të tilla. Mirëpo, fatkeqësi të tilla kemi pa në shumë vende, por Kosova nuk është vend që zakonisht e godasin këto fatkeqësi natyrore. Pasi që nuk ka debat për këtë pikë, për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2026.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për dymbëdhjet komunat në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt (ZMM- 5).**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.**

Si pikë e parë e rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për këtë pikë? Jo. Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

- 2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2026**

zn.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit. Po ju prezantojmë, në pika të shkurta, pasqyrat financiare për periudhën janar-qershor 2026. Buxheti i aprovuar për vitin 2026, në total për të gjitha kategoritë ekonomike, është **18.488.295,85 €**. Buxheti i alokuar për periudhën janar-qershor 2026, për

trasha. Për disa pika kisha kërku sqarime më të detajuara. Te krahasimi me të hyrat për periudhën janar–qershor 2025 me të hyrat e këtij viti 2026, e përmende që janë më të ulëta për mbi **58 mijë euro**. Do të doja me pasë një sqarim se pse ka ndodhë kjo rënie. Tek shpenzimet për të gjitha njësitë buxhetore, e kam vërejtë që shumë shpesh po ndodh që kemi kode të reja buxhetore që na vijnë automatikisht. Ka ndodhë që një kohë të gjatë nuk ka qenë një kod, por në një moment është kriju dhe brenda atij kodi është vendosë një shumë e caktuar. Dua me ditë se si shtohen këto kode: a janë të njëjta për të gjitha komunat, apo bëhet kërkesë nga Komuna? Sa kohë merr procedura për me shtu një kod të ri buxhetor dhe sipas çfarë kriteresh bëhet ndarja e mjeteve? Kjo më ka interesu edhe më herët, por tash po e shoh që janë tu u shtu shumë kategori si: shërbime të veçanta, konsulentë dhe kontraktorë individualë, kompensim i përfaqësimit brenda vendit e të tjera. Për sqarim shtesë, në seancë po i përmendi disa shembuj: transporti për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit – ku janë realizu këto udhëtime, kush kanë qenë personat dhe ku kanë shku këto mjete; telefonia mobile; shërbimet e ndryshme shëndetësore; shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale; shërbimet kontraktuese tjera; pajisje tjera; furnizimi për zyre, mbi **34 mijë euro**; mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve; kompensimi i përfaqësimit brenda vendit. Këto janë disa prej kodeve që kanë shuma më të mëdha dhe që më kanë ra në sy. Për këto dua me pasë informacion shtesë që të vijë në Kuvend. Ne kemi kërku edhe më herët, por kësaj here do të ishte mirë që të na vijnë më në detaje. Janë rreth nëntë kode buxhetore për të cilat po kërkoj me i pasë sqarimet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Te transporti brenda dhe jashtë vendit, këtu përfshihen të gjithë ata persona që janë me aftësi të kufizuara, nxënës të cilët barten nga shtëpia deri te shkolla, si dhe zakonisht këto jashtë vendit janë shoqëritë kulturore-artistike, të cilat merren me autobus dhe dërgohen. Sa i përket çështjes që e ngri, edhe mua më ra në sy që kemi rreth **58 mijë euro** më pak krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shumica e këtyre të hyrave kanë ngecë. Disa kanë qenë në parametrat e caktuar, disa edhe i kanë tejkalu, por megjithatë tatimi në pronë ka ngecë më së shumti. Deri tani nuk kemi pasë asnjë masë të detyrueshme, por drejtoresha dhe në Bordin e Drejtorëve tregoi që ka marrë një vendim, të cilin ia ka dërgu Drejtorisë së Kadastrit, që te pronat ku bëhet shitblerja, në rast se ajo pronë ka obligime të papaguara të tatimit në pronë, të kushtëzohet regjistrimi i saj në librat kadastralë deri sa të kryhet obligimi ndaj Komunës. Besoj që kjo ka me ndiku pozitivisht dhe ka me i rritë të hyrat, sepse po na krijohet një borxh fiktiv. Ish-pronari nuk po e pague pasi i ka marrë paratë, ndërsa pronari i ri nuk po e merr përsipër atë obligim. Katër çështje në Bordin e Drejtorëve i kam shtruar dhe. E para, duhet me u shfrytëzu tatimi në pronë, sidomos tash kur jemi në sezonin e verës, sepse jo vetëm në Viti përdoren pronat. Deri në mars shpesh vonohen pagesat, sepse qytetarët mund të mos jenë aty, e shtëpitë i kanë të mbyllura deri në atë periudhë. Duhet me pasë një plan veprimi dhe me i njoftu qytetarët që obligimet me i kry me kohë. Çështja tjetër është shfrytëzimi i hapësirave publike dhe kryerja e obligimeve ndaj Komunës. Po ashtu, është edhe çështja e ngritjes së vetëdijes për legalizimin e objekteve, sipas udhëzimit administrativ dhe kategorive që përfshihen aty. Këto janë disa prej shtyllave që besoj se i bëjnë mirë Komunës dhe institucioneve, duke e pasë parasysh edhe realizimin që po bëhet përmes Komunës. Sa i përket kontratës kolektive, si pasojë e saj kemi operatorë ekonomikë të cilët tash kanë me na marrë mjete, sepse ne nuk i kemi pasë ato para dhe ata detyrohen me i ndjekë këto forma për me i realizu kërkesat e tyre.

z.Basri Aliu: Përsëritje për të gjithë. Vendimi që po dashka me marrë drejtoresha duhet me u kqyr edhe nga ana ligjore, a ka të drejtë, që mos po shkelen të drejtat kushtetuese të individit. Sepse një qasje të tillë e kemi pasë edhe me vërtetimet për regjistrimin e veturave dhe ka dalë që ka qenë antikushtetuese. Edhe unë jam për këto veprime, veç duhet me pasë kujdes që të jenë në përputhje me ligjin. Ndërsa, te pika për shpenzimet buxhetore, një pyetje për drejtoreshën: e di që vështirësitë janë të mëdha në Komunë dhe nuk kisha dashtë me qenë në lëkurën e saj për këto çështje, sepse po rrezikohet edhe funksionimi vital i Komunës. Mirëpo, ajo që më intereson është: sa është shfrytëzu buxheti i Komunës dhe sa buxhet na ka mbetë? Duke e pa, për shembull, te Shërbimet Publike, buxheti është **1 milion e 672 mijë euro**, janë shpenzu **1 milion e 475 mijë euro**, që i bie

se kanë mbetur rreth **223 mijë euro** deri në fund të vitit. Kjo është një vështirësi e madhe për drejtorinë. Gjithashtu, po nisem prej këtyre dy drejtorive që janë më të cenueshme në këtë drejtim. Edhe te Drejtoria e Shëndetësisë po shoh që është shpenzu shumica e buxhetit dhe e keni bërë kërkesën në Qeveri që në një formë të kërkohej buxhet shtesë, në mënyrë që të tejkalohet kjo vështirësi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në kuadër të këtyre pagesave gjyqësore, a keni ndonjë informatë ose llogaritje se sa i takojnë kontratës kolektive dhe sa u takojnë pjesëve të tjera? Nëse e bëni një llogaritje ndërkohë, ju lutem ma ktheni përgjigjen.

z.Ilir Zuka: Kërkojnë informacion prej Klubit Futbollistik Vllaznia. Ne e dimë që i kemi bërë disa ndryshime buxhetore. A ke diçka të re rreth tribunave?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë kam kontakt me Valmin dhe ai ka hyrë në kontakt me ministrin. Ministri ka thënë: "Unë do ta vizitoj palestrën e sportit", dhe në atë temë është çështja e stadiumit të Pozheranit. Ka thënë se duhet me më pritë kryetari i komunës. Kryetari ia kam përcjell këtë dhe ka thënë që do ta presë. Jemi tu pritë, në kuadër të kësaj, me u realizu. Sa i përket mundësive tona buxhetore, janë shumë minimale. Ne kodet i kemi ndryshu, por pare a kemi? Çdo mjet që është sot, nesër nuk është, se i marrin. Këto janë telashet. Vullneti i komunës ka qenë për me i bërë dhe i meriton.

z.Ilir Zuka: A keni informacion që është bërë një memorandum me u bërë tribunat në Sodovinë dhe jo në Pozheran? Këtë duhet ta keni parasysh, se do të bëhen tribunat në Sodovinë, jo në Pozheran.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë për këtë nuk e di dhe ka me e ngritë këtë çështje, ka me pyet. Unë konsideroj se prioritet duhet t'i ipet stadiumit të Pozheranit. Kështu mendoj individualisht, jo si nënkryetar komune.

z.Jakup Demiri: Ajo puna e Sodovinës është që ata e kanë gjetë një kanal. Ajo nuk është e Pozheranit që është tu ia marrë Sodovinës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: nëse komuna ka bërë një memorandum me ta atëherë ne kemi gisht aty por nëse nuk eka bërë zyrtarisht komuna ministri mundet me investu kudo nuk mundesh me ndalë.

z.Ilir Zuka: drejtoresh kërkoj një poergjigje qytetareve të pozheranit me bërë publikisht ndaj tribunave se qka është tu ndodh, kjo me ne ardh në kuvend.

z.Basri Aliu: Mundet me ndodhë, shembull si ka qenë te Ministria e Arsimit me shkollat që i ka ndërtu. Ka pasë me ndërtu edhe palestër sportive. Ndoshta edhe kjo është, se unë nuk e di, veç shembull po e marr. Ndoshta edhe stadiumi i Sodovinës është kështu.

z.Jakup Demiri: Liga e veteranëve që luajnë e ka një fond. Në bazë të asaj përfiton Uniteti, po ata po dojnë me i bindë që me investu aty.

z.Ilir Zuka: Në takim me ministrin është dakordu që stadiumit të Unitetit t'ju ndërtohen tribunat. Kam informacion të saktë.

z.Jakup Demiri: Merre, shikoje, e ke paragrafin. Çdo komunë u kanë fituese e cila nuk ka pasë stadium ndihmës. Ato fusha nuk do të thotë që ju ipen atij ekipi, po thotë që ju ipen territorialisht brenda një komune dhe ka me shërby për të gjitha ekipet që hyjnë në Superligë dhe më vonë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jakup, pajtohem me ty se atë kohë kam qenë në rrjedha. Sokol Haliti në atë kohë ka qenë, pastaj ka ardhë Naim Pira. Unë e kam thirrë sekretarin e Federatës së Futbollit të Kosovës dhe i kam thanë: "E kemi gjendjen me plan zhvillimor komunal, është e parapame në Sodovinë." Thotë nënkryetari i komunës: "Në rast se don me nxan hapin dhe stadiumin me ndërtu para të tjerëve, duhesh në përputhje me planin zhvillimor komunal, se nuk e ndërtojmë." Dhe unë e kam shpjegju drejtë këtë punë. Ka dalë ai i Federatës së Futbollit, nuk përzihet pa plan zhvillimor komunal. A e ka fitu Klubi Futbollistik Vllaznia e Pozheranit, Jakup? Këtu e dimë që po. Prej 12 ekipeve që kanë qenë në Superligë, ka qenë dhe fituese Pozherani.

z.Illir Zuka: Kur kemi hy ne në Superligë, Ballkani ka qenë në Ligën e Dytë. Ekipet e Superligës i kanë fitu fushat ndihmëse.

z.Jakup Demiri: Kur është nënshkruar kjo marrëveshje, Ballkani ka qenë kampion i Kosovës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Si është tani, këtë nuk e di, por që kemi në kod buxhetor në investime kapitale, krejt e dimë që i kemi. Me pasë pare, na startojmë me procedurë. Pasi që nuk ka më për debat, vazhdojmë me pikën tjetër.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për dymbëdhjet komunat në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit (ZMM- 5)

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është plan që e ka bërë GIZ-i, komunat janë veç tu participu me informata. Unë nuk kam çka me diskutu te kjo, të njëjtën e kanë edhe komunat tjera. A përputhet a nuk e kanë bërë mirë, ato varen prej ministrisë. Ne nuk kemi mundësi me bërë diçka, se nuk e bën komuna e Vitisë, por bëhet e përgjithshme. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-278, të datës 02.03.2026, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: I keni dy ndryshime në KKSB, njëri nga KLSP-ja dhe tjetri nga përfaqësuesi i Kishës Katolike. Nga KLSP-ja e qytetit të Vitisë zëvendësohet Enver Osmani me Arben Jakupin, ndërsa nga përfaqësuesi i Kishës Katolike, Nikoll Ukaj zëvendësohet me Krist Gjergjin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Me të gjitha votat pro, miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Komisioni që kemi formu ka pas takimin, ka diskutu për planin e Kuvendit Komunal. Propozimi i parë vjen në Kuvend dhe këtë propozim duhet me qitë në diskutim publik, pastaj vjen në Kuvend, votohet. Pak ndryshime ka prej pjesës së kalume. Materialin e keni të gjithë. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë.

Ju falënderoj për kontributin e dhënë. Shihemi herave tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi - Pranimi Me Datë 06-08-2026			
Nr. Llogarit Org. Hra	Nr. Llogarit Org. Hra	Subjekt Rrethi	Vlera Vendim
02	016/02	790	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



ZYRA E PROKURIMIT

**Për: Komitetin për Politikë dhe Financa të Kuvendit komunal
të Vitisë**

INFORMATË E PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA PËR VITIN FISKAL 2026

(JANAR-QERSHOR 2026)

Korrik, 2026

Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Raport pune për gjashtëmujorin e vitit 2026, për kryetarin e komunë, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik duke përmbledh të gjitha aktivitetet e prokurimeve për gjashtëmujorin e vitit 2026, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit deri në lidhjen e kontratave dhe aktivitetet tjera të zhvilluara në këtë periudhë kohore, që po raportojmë.

Përmes këtij raporti do të paraqesim të dhëna e aktivitetet e prokurimit të përmbledhur që janë zhvilluar për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve gjegj. investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit të këtij viti e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenjes qytetare në përgjithësi, punët dhe aktivitetet që zyra e prokurimit i zhvillon për një vit buxhetor gjegj kalendarik.

Në periudhën kohore Janar- Qershor 2026, duke u bazuar në kërkesat e Njësive shpenzuese dhe nevojave të tyre, zyra ka inicuar 27 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna;

- 12 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime,
- 3 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe
- 12 me lëndë prokurimi Furnizime.

Nga këto aktivitete, 14 janë përbyll si aktivitete, 1 të tjerat janë anuluar. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 20 raste është përdorë procedura e hapur, 5 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 2 aktivitete procedurë me Vlera minimale.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 14 aktivitete të prokurimit, janë përbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; 1 aktivitete të prokurimit janë anuluar, një (1) aktivitete janë në procedure të ankimit, dhe 11 janë ne procedure.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura për gjashtëmujorin e vitit 2026, është **2,709.455.40 €**.

Ndër shërbimet që Zyra e prokurimit është edhe nxjerrja e Urdhërblereve për fillimin e punëve dhe porositë të mallrave dhe shërbimeve dhe procedimi i pagesave, gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **466 Urdhërblere** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësisht ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe **50** rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera.

Në fund të këtij Raporti duhet veqar se Zyra e prokurimit për gjashtëmujorin e vitit 2026, ka ofruar edhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë Njësive shpenzuese, duke ofruar këshilla dhe shërbime profesionale, me qëllimin e të ofrimit të në komunë për bizneset dhe komunitetin e gjërë duke u bazur në respektimin dispozitave ligjore në fuqi por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kan ardhur në Zyrë tonë



Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Fadil ABAZI



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Norma nën 87.2.9.12 të Ligjit Nr. 04/L042, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë

Data e përgatitjes së raportit:	31.12.2026	Viti fiskal	2026
---------------------------------	------------	-------------	------

PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	KOMUNA E VITISË		
Lloji i Autoritetit Kontraktues (zgjidhëne njëren)			
Kodi buxhetor	Vi657		
Adresa	Viti, rruga "28 Nëntori"		
Kodi postar - Qyteti	61000 Viti		
Tel. fiks/ Celulari/ Faksi	0280/381 519	044 505 984	
Emri i menaxherit të prokurimit	Fadil ABAZI		
E-mail adresa	fadil.n.abazi@rks-gov.net		
Adresa e webit të AK	kk.rks-gov.net/viti/		

PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Nr. i Prokurimit						Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës (zotimit)	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Selia e OE të cilit i është dhënë kontrata	OE vendor (1); Jo vendor (2)	Afati kohor i shërbimit (1)	Afati kohor i shërbimit (2)	Çmimi më i ulët (1)
Numri rendor i prokurimit	Numri prokurimit në sistemin	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2) shifrat e para të FPP)											
2	3	4	5	6	7	8	9.00	10.00	11	12	13	14	15	16		
001	046	1	3	6	78	Furnizimi me dokumente shëndetësore – receta të barnave për QKMF-në	01.04.2026	6,500.00	5,810.00		Nita Macula B.I.		1	1	1	
002	073	1	2	1	02	Furnizimi me pelet për QMF-s në Pozheran dhe shkollat	11.02.2026	25,800.00	24,756.00		Bek Fluids L.L.C.		1	1	1	
003	089	2	1	1	93	Shërbimet e kujdesit social dhe shëndetësor shtëpiak - paliativ i të sëmurave në Komunën e Vitisë - Dy vjeçar	31.03.2026	900,000.00	900,000.00		C.I.K CARITAS KOSOVA		1	1	1	
004	108	2	1	1	93	Shërbimet e mbështetjes profesionale me kompetencën për ofrimin e shërbimeve publike dhe mirëqenjes qytetare- Dy vjeçar	01.04.2026	980,000.00	968,056.60		KosovaMed Healthcare SH.P.K.		1	1	1	
005	194	1	1	1	22	Furnizim me material të shtypur, material reklamues dhe të gravuar për të gjitha Njësitë shpenzuese- Tre vjeçar	15.04.2026	180,000.00	180,000.00		Studio Grafike „Visual Media +“		1	1	1	
006	195	2	3	6	93	Shërbimet e Zëritit për nevojat e komunës dhe shkollave, LOT I, dhe LOT II.	27.02.2026	8,500.00	6,540.00		Berat B. Shabani B.I.		1	1	1	
007		1	2	1	15	Furnizim me pemë dhe perime për çerdhe dhe kabinete të teknologjise ushqimore	17.03.2026	15,000.00	10,810.00		BURIMI CORPORATIO N SH.P.K.		1	1	1	

008		2	1	1	93	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	17.04.2026	200,000.00	200,000.00	PLUS TRADE L.L.C		1	1	1
009		2	2	1	93	Shërbimet e xhirimit dhe transmetimit televiziv për nevojat e Komunës së Vitisë dhe Kuvendi		40,000.00		PROCEDURE		1	1	1
010	820	2	1	1	93	Shërbimet e Mirëmbajtjes; LOT I, Mirëmbajtja dhe servisimit të automjeteve zyrtare dhe LOT.II, Mirëmbajtja dhe servisimi i gjeneratoreve.		180,000.00		PROCEDURE		1	1	1
011		1	2	1	29	Furnizimi me mjete mekanizëm bujqësor	13.05.2026	252,350.00	252,350.00	N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.		1	1	1
012		1	2	1	25	Furnizimi me serra 50m2	12.06.2026	97,500.00	0.00	ANULIM		1	1	1
013		1	2	1	33	Furnizim me material për stomatologji	16.07.2026	24,000.00	24,000.00	MESE PHARM SH.P.K.		1	1	1
014		5	2	1	45	Funksionalizimi i ujësjellësve ne 5 fshatrat Sllatinë e Ultë, Sllatinë e Epërme, Trestenik, Sodovinë e Jerlive dhe S. e Qerkezëve,	17.06.2026	60,000.00	59,989.00	KUSHTRIMI NM SH.P.K.; ENGINEERING RK		1	1	1
015		2	2	1		Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe servisimit te ashensorit ne QKMF-s		8,000.00		PROCEDURE		1	1	1
016		1	2	1	33	Furnizim me pajisje speciale mjeksore		20,000.00		PROCEDURE		1	1	1
017	3468	2	1	1	93	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, shëndetsore dhe arsimore të Komunës së Vitisë+DDD - Tre vjeçar		1,590,000.00		PROCEDURE		1	1	1
018	2992	5	5	8	30	Furnizim me kompjutera dhe pajisje te TI		25,000.00		PROCEDURE		1	1	1
019		1	2	1	24	Furnizimi me kurora dhe buqeta lulesh-tre vjeçar		8,850.00		PROCEDURE				
020	3449	2	2	1	93	Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, aksesore dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues	12.06.2026	15,000.00	11,480.00	DRITË GROUP KS SH.P.K.; GRAMOFON SH.P.K.		1	1	1
021		2	1	1	93	Sigurimi i automjeteve të komunës së Vitisë		9,950.00		PROCEDURE		1	1	1
022		2	1	1	74	"Programimi për eficiencë të energjisë dhe burimet e ripërtitshme të energjisë - pompa Termike ne objektet Arsimore,Shëndetsore dhe Komunale të Vitisë" (Hartimi i projektit dhe Auditimi)		200,000.00		PROCEDURE		1	1	1
023		1	3	6	11	Furnizim me oksigjen medicinal- dy vjeçar		8,000.00		PROCEDURE		1	1	1
024		1	1	1	28	Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit- dy vjeçar		200,000.00		PROCEDURE		1	1	1

025		1	2	1	17	Furnizim me rekuizita sportive për nevojat e Drejtorisë së Sportit dhe Drejtorisë së Arsimit		89,277.00		PROCEDURE				
026		5	2	1	45	Ndërtimi i palestrës sportive shkollore (Sh.f Sllatinë e Epërme)- Faza e dytë.	24.07.2026	67,660.00	65,663.80	EURO COMMERCE- ATC.COM				
027		5	2	1	45	Renovimi i shkollave dhe i të gjitha institucioneve komunale në Komunën e Vitisë.		388,554.00		PROCEDURE				
TOTALI (10+11) :								5,599,941.00	2,709,455.40					

